



REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES - VLADA E KOSOVES - GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVSTVA - MINISTRY OF HEALTH	
Number Orig. / Original / Orig. Datum: 02	File Print: 05-4793
File Page(s) / Stranice / In paper: -4-	Date: 09/08/2023
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë / Ministry of Health / Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE

MENAXHIMI I MBETURINAVE RADIOAKTIVE

VERSIONI: [1.0]
DATA E APROVIMIT: [07/08/2023]
AUTOR: [MSh]
NR. I HAPAVE: [V]
NR. I NËNHAPAVE: [XVII]

APROVUAR: ^{pe} Dr. Naim Bardiqi,
Sekretar i Përgjithshëm, MSh



Prishtinë / a

QËLLIMI	<p>QËLLIMI I PROCEDURËS STANDARDE OPERATIVE (PSO) ËSHTË DEFINIMI I HAPAVE KONKRET TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE RADIOAKTIVE NË INSTITUCIONE SHËNDETËSORE ME QËLLIM TË MBROJTJES SË SHËNDETIT TË PROFESIONISTËVE SHËNDETËSOR, SHËNDETIT PUBLIK DHE TË MJEDISIT.</p> <p>KJO PSO DUHET TË ZBATOHET NË TË GJITHA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE TË CILAT GJENEROJNË MBETURINA RADIOAKTIVE.</p>
NDËRLIDHJA ME AKTET	<ol style="list-style-type: none"> 1. LIGJI NR 04/L125 PËR SHËNDETËSI; 2. LIGJI NR. 04/L-060 PËR MBETURINA; 3. UA MPMH-NR. /2017 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE MEDICINALE PATOLOGJIKE; 4. UA MMPH NR 10/2015 PËR TRAJTIMIN E MBETURINAVE NGA PRODUKTET MEDICINALE;
LISTA E SHKURTESAVE & DEFINICIONET	<p>AMRRSB - AGJENCIA PËR MBROJTJE NGA RREZATIMI DHE SIGURI BËRTHAMORE;</p> <p>MMPHI - MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS;</p> <p>MSH - MINISTRIA E SHËNDETËSISË;</p> <p>PSO - PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE;</p> <p>UA - UDHËZIM ADMINISTRATIV;</p> <p>MBETURINA RADIOAKTIVE – MBETURINA ME PËRMBAJTJE TË SUBSTANCAVE RADIOAKTIVE QË MUËND TË JENË NË GJENDJE TË GAZTË, LËNGËT OSE TË NGURTË (P.SH. MATERIALE TË PASHFRYTËZUARA PËR RADIOTERAPI OSE PËR QËLLIME HULUMTIMI; MJETE QELQI, LETRE APO PLASTIKE TË KONTAMINUAR NGA MATERIALI RADIOAKTIV; URINË APO EKSKRETE NGA PACIENTËT E TRAJTUAR OSE TESTUAR ME BURIME TË HAPURA RADIOAKTIVE; BURIMET E MBYLLURA).</p>

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Paketimi i Mbeturinave Radioaktive	<ol style="list-style-type: none"> 1. Grumbullimi i mbeturinave radioaktive bëhet varësisht nga gjenerimi i tyre dhe lloji i izotopit (koha e gjysmë zbërthimit); 2. Mbeturina radioaktive që përmban izotope me gjysmë jetëgjatësi të ndryshme duhet të ndahet në kutinë e sigurisë dhe të vendosen në kontejnerë të plumbit për grumbullimin e mbeturinave radioaktive; 3. Në kontejnerë të plumbit duhet të shënohet emri i izotopit, lloji i aktivitetit radioaktiv (mbeturina jetëshkurtër, me nivel shumë të ultë, nivel të ultë, nivel mesatar, nivel të lartë) dhe datën kur u monitorua për herë të parë; 4. Lloji i kontejnerëve ku vendosen mbeturinat radioaktive duhet të jetë nga plumbi.
[II]	Shenjzimi i Mbeturinave Radioaktive	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbeturinat radioaktive duhet shenjzuar me simbolin për mbetjet radioaktive; 2. Mbeturinat, që do të ruhen gjatë zbërthimit (DECAY) radioaktiv, duhet të etiketohen me llojin e radionuklidit, datën, periudhën kohore të zbërthimit të plotë dhe detajet e kushteve të kërkuara të ruajtjes (Standardet e Sigurisë së IAEA, Klasifikimi i Mbetjeve Radioaktive – Udhëzuesi i Përgjithshëm i Sigurisë Nr. GSG1, 2009).
[III]	Ruajtja e Mbeturinave Radioaktive	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ruajtja e mbeturinave radioaktive duhet të bëhet në konsultim me personin përgjegjës për radioaktivitet, që duhet të jetë fizikant mjekësor¹ apo ekspert i mbrojtjes nga rrezatimi i certifikuar nga AMRrSB; 2. Mbeturinat radioaktive duhet të ruhen në kontejnerë që parandalojnë shpërndarjen e rrezatimit, dhe të ruhen në kuti nga plumbi; 3. Mbeturinat radioaktive me gjysmë jetë më shumë se 100 ditë duhet të grumbullohen dhe ruhen në kontejner special plumbi, në hapësirën e mjekësisë nukleare të institucionit përkatës, deri në vendimin e AMRrSB në përputhje me rregulloret kombëtare; 4. Dhoma e ruajtjes duhet të shënohet me shenjën “rrezik nga rrezatimi” dhe të jetë e monitoruar me kamerë; 5. Shiringat dhe gjilpërat që përdoren për dhënien e materialit radioaktiv pacientit, pas injektimit të dozës, duhet të hedhen në

¹ Fizikanti mjekësor është person i punësuar në institucionet shëndetësore dhe zbaton njohuritë e tij nga shkenca e fizikës, në zhvillimin dhe përdorimin e trajtimeve, diagnostikimit, përdorimin e pajisjeve dhe teknologjisë me substancave radioaktive.

		<p>kutinë e sigurisë;</p> <p>6. Kutia e sigurisë vendoset në kontejner plumbi (special) dhe të qëndroj minimum 5 ditë;</p> <p>7. Pas 5 ditëve, ato duhet të trajtohen njëjtë sikurse mjetet tjera të mprehta.</p>
[IV]	Transporti i Mbeturinave Radioaktive	<p>1. Transporti i mbeturinave radioaktive duhet të bëhet me automjet special të certifikuar nga AMRrSB;</p> <p>2. Stafi që bën transportin e mbeturinave radioaktive duhet të ketë leje nga AMRrSB.</p>
[V]	Asgjësimi i Mbeturinave Radioaktive	<p>1. Asgjësimi i mbeturinave radioaktive duhet të bëhet në depo kombëtare të asgjësimit, të kontrolluar dhe menaxhuar nga AMRrSB;</p> <p>2. Deri në krijimin e depos kombëtare, mbeturinat radioaktive duhen të ruhen nga institucioni përkatës, që gjeneron material radioaktiv, sipas hapit III, pikat 1 – 3.</p>

Referenca:

1. *Safe management of wastes from health-care activities Second edition Edited by Yves Chartier, Jorge Emmanuel, Ute Pieper, Annette Prüss, Philip Rushbrook, Ruth Stringer, William Townend, Susan Wilburn and Raki Zghond, World Health Organization 2014.*